



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1421/1 Prot.

Tiranë, më 16 / 10 / 2018

### V E N D I M

#### Nr. 199, datë 16 / 10 / 2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën 52, datë 26.04.2018, të paraqitur nga D.H kundër Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “shtatzanisë<sup>1</sup>”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

### K O N S T A T O I :

#### **I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Shtetasja D.H shpjegon se ka filluar punë pranë FSDKSH që në muajin Shkurt 2013. Në datë 18.04.2017 ka filluar lejen e lindjes dhe është rikthyer në punë në datë 03.04.2018. Ditën që është rikthyer në punë, me shkresën nr.1592, datë 03.04.2018 nga FSDKSH është njoftuar për takim për të diskutuar lidhur me vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të institucionit. D.H informon se në datë 25.01.2018 është punësuar zëvendësuesi, L.Ç, i cili për një periudhë më pak se 3 muaj, në datë 03.04.2018 ka marrë emërimin definitiv në drejtorinë ku ajo punon.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rikthimin në vendin e punës.

Në datë 07.05.2018, subjekti ankues ka dorëzuar<sup>3</sup> pranë zyrës së Komisionerit informacion dhe dokumentacion plotësues në lidhje me pretendimet e paraqitura.

#### **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.**

<sup>1</sup> D.H nga data 18.04.2017 deri në datë 03.04.2018 ka qenë me leje lindje dhe është nënë e një fëmije 1 vjeç.

<sup>2</sup> Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën: KMD.

<sup>3</sup> Referuar procesverbalit datë 07.05.2018.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtua shqyrtimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

- A. Me shkresën nr. 569/1, datë 10.05.2018 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, FSDKSH, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga D.H.

Me shkresën nr. 2309/1, datë 11.06.2018, administruar me tonën nr. 569/2, datë 18.06.2018 FSDKSH në mes të tjerash ka informuar Komisionerin se: “Fondi ushtron veprimtarinë e tij në bazë të Ligjit nr.10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të Vendimit nr.124, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të FSDKSH në RSH” të ndryshuar. Me Urdhrin nr.114, datë 29.05.2013, të E.H, Drejtore e Përgjithshme e ISKSH, D.H është emëruar në pozicionin specialiste në Sektorin e Analizës së Rimbursimit të Barnave pranë Drejtorisë së Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave të Drejtorisë së Përgjithshme të Fondit. Me Vendimin nr.63, datë 25.09.2017, të Këshillit Administrativ “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Fondit”, struktura e Fondit është pakësuar me 163 punonjës. Rishikimi i strukturës ka ardhur si

*domosdoshmëri pas konstatimeve se struktura e Fondit kishte mbivendosje të pozicioneve të punës, pozicione pune që nuk justifikonin ngarkesën dhe objektivat e vendosura. Objekt i këtij rishikimi ka qenë dhe Drejtoria e Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave, ku ka qenë e emëruar D.H. Kjo drejtori ka pasur ndryshim të strukturës së brendshme, si dhe shkurtim të pozicioneve sipas konstatimeve të grupit të punës për rishikimin e strukturës, pasi nuk është veprimtari e fushës së saj “çmimi”, për këtë arsye kjo drejtori ka ndryshuar edhe në emërtesë. Gjithashtu janë shkrirë pozicione pune që nuk përkonin me objektivat e kësaj drejtorie, si dhe janë grupuar funksione apo detyra që për shkak të natyrës duhet të ishin të përqëndruara në një strukturë. Ju bëjmë me dije se D.H ka qenë me leje lindje nga data 18.04.2017 deri më datë 25.03.2018. Pas përfundimit të lejes së lindjes, bazuar në raportin e datës 26.03.2018, ankuesja ka qenë me paaftësi të përkohshme në punë nga data 26.03.2018 deri në datë 31.03.2018. Në datë 02.04.2018, ankuesja është paraqitur në vendin e punës. Me shkresën nr.1592, datë 03.04.2018 ankuesja është njoftuar për një takim për të diskutuar lidhur me vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës. Takimi është zhvilluar në datë 06.04.2018. Me Urdhrin nr.274, datë 16.04.2018 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, në zbatim të dispozitave të Kodit të Punës, D.H i është komunikuar se marrëdhëniet e punës do ti ndërpriten pas periudhës tre mujore, me datë 16.07.2018. Në mbështetje të kodit të punës është kryer zgjidhja e kontratës individuale të punës me D.H, duke zbatuar procedurat e parashikuara në nenin 92, 94, 143 dhe 145 të Kodit të Punës, ku janë respektuar afati i njoftimit prej tri muajsh në respektim të kohëzgjatjes së punësimit, shpërblimi për vjetërsi me tri paga mujore, shpërblimi për leje vjetore të pakryer, si dhe 20 orë leje në javë të pagueshme për të kërkuar një punë të re”.*

**B.** Me shkresën nr.569/3, datë 20.06.2018 Komisioneri duke vlerësuar se përgjigja e FSDKSH, nuk ishte e plotë lidhur me pretendimin e ankueses se është punësuar një punonjës i ri në Drejtorinë e Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave si dhe shpjegimet lidhur me ndryshimin e strukturës së drejtorisë, Komisioneri ka kërkuar shpjegimet e mësipërme brenda datës 26.06.2018.

**C.** Me shkresën nr.2309/3, datë 06.07.2018 të administruar me tonën me nr.569/5, datë 12.07.2018, FSDKSH dërgoi dokumentacionin si më poshtë: - Kopje të strukturës organike të mëparshme të Drejtorisë së Çmimeve dhe të përshkrimeve të punës. - Kopje të strukturës organike të re të Drejtorisë së Rimbursimit dhe përshkrimeve të punës.

**D.** Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes së D.H, Komisioneri me shkresën nr. 569/4, datë 10.07.2018 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 18.07.2018.

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 18.7.2018, mori pjesë subjekti ankues dhe përfaqësuesit e FSDKSH.

Sipas përfaqësuesit të FSDKSH, gjatë procesit të ristrukturimit në Drejtorinë e Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave për shkak të listës së barnave ka patur ngarkesë në punë dhe për të plotësuar këto nevoja, është bërë emërimi në punë i L.Ç, i cili ka patur përvojë të gjatë pune në fushën e farmaceutikës. Gjatë procesit të ristrukturimit, Komisioni ka vlerësuar të gjithë

punonjësit dhe ka vendosur që Drejtoria e Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave nga 3 sektorë me 12 punonjës të bëhej Drejtoria e Rimbursimit me 2 sektorë dhe 10 punonjës. Procesi i ristrukturimit ka prekur të gjithë strukturën e Fondit përfshirë dhe punonjëse të tjera me leje lindje, si A.H të cilës iu ristrukturoa vendi i punës dhe I.V e cila është me leje lindje por është sistemuar në një pozicion tjetër brenda strukturës së Fondit.

Ankuesja gjatë seancës dëgjimore sqaroi shkaqet dhe pretendimet e ngritura në ankesë dhe kërkoi rikthimin në pozicionin e mëparshëm të punës.

**E.** Me shkresën nr.2309/5, datë 18.07.2018 të administruar me tonën me nr.1064, datë 27.07.2018, FSDKSH dërgoi listën e punonjësve me leje lindje gjatë vitit 2017-2018 si më poshtë:

1. A.H me leje lindje 04.01.2017 deri datë 04.12.2017.
2. A.LL me leje lindje deri në datë 27.12.2017.
3. S.D me leje lindje deri më datë 22.04.2017.
4. E.H me leje lindje deri në datë 17.07.2017.
5. J.O me leje lindje deri në datë 07.04.2017.
6. B.S me leje lindje 04.05.2017 deri në 13.11.2017.
7. D.H me leje lindje nga data 18.04.2017 deri në datë 23.03.2018.
8. E.M me leje lindje 11.10.2017 e në vazhdim.
9. I.V me leje lindje 01.02.2018 e në vazhdim.

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.**

Referuar dokumentacionit të depozituar, në cilësinë e provës nga të dy palët në proces, rezulton se ankuesja me Urdhrin nr.114, datë 29.05.2013 të E.H, Drejtore e Përgjithshme e ISKSH është punësuar në pozicionin si specialiste në Sektorin e Analizës së Rimbursimit, pranë Drejtorisë së Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave të ish ISKSH, aktualisht Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Referuar raporteve mjekësore për leje barrë lindje, vërtetohet se D.H ka qenë me leje lindje nga data 18.04.2017 deri më datë 25.03.2018, dhe pas përfundimit të lejes së lindjes, nga data 26.03.2018 deri në datë 31.03.2018 ka qenë me raport për paaftësi të përkohshme në punë.

Në datë 02.04.2018, ankuesja është paraqitur në vendin e punës. Me shkresën nr.1592, datë 03.04.2018 ankuesja është njoftuar nga punëdhënësi për takim për të diskutuar lidhur me vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës. Takimi është zhvilluar në datë 06.04.2018. Me Urdhrin nr.274, datë 16.04.2018 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës”, D.H i është komunikuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës, pasi i është ristrukturuar dhe riemëruar pozicioni i punës, për shkak të ristrukturimit të institucionit dhe do t’i ndërpriteshin marrëdhëniet e punës pas periudhës tre mujore, në datë 16.07.2018 sipas procedurave të parashikuara në Kodin e Punës.

Referuar dokumenteve të vëna në dispozicion nga FSDKSH, rezulton se me Vendimin nr. 63, datë 25.09.2017, Këshilli Administrativ i FSDKSH, bazuar në kompetencat e përcaktuara në VKM nr 124, datë 05.03.2014 “Për miratimin e statutit të FSDKSH në Republikën e Shqipërisë”<sup>4</sup> ka vendosur të miratojë pakësimin prej 163 punonjësve në numrin total të punonjësve të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, ku përfshihen edhe Drejtoritë Rajonale të FSDKSH-së, nëpër rrethe. Në vijim të vendimit të sipërpërmendur, është miratuar Vendimi nr. 14, datë 02.02.2018, i Drejtorit të Përgjithshëm, të FSDKSH-së “Për miratimin e strukturës organizative, strukturës së brendshme dhe të rregullores për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës së Fondit të Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor”.

Në këto kushte, Komisioneri gjykon se procesi i ndryshimit struktural të këtij institucioni është një proces madhor që ka prekur këtë institucion në tërësinë e tij, duke suprimuar 163 pozicione pune dhe ky proces ristrukturimi nuk ka prekur vetëm pozicionin e punës së D.H, por 163 pozicione pune të ndryshme në nivel qendror dhe rajonal duke ndryshuar dhe kriteret dhe përshkrimet e punës së pozicioneve të punës.

Në vijim të kryerjes së këtij ristrukturimi institucional, Komisioneri ka konstatuar se në mbështetje të Kodit të Punës është kryer zgjidhja e kontratës individuale të punës me ankuesen, duke zbatuar procedurat e parashikuara në nenin 92, 94, 143 dhe 145 të Kodit të Punës, ku janë respektuar afati i njoftimit prej 3 muajsh në respektim të kohëzgjatjes së punësimit, shpërblimi për vjetërsi me 3 paga mujore, shpërblimi për leje vjetore të pakryer, si dhe 20 orë në javë leje të pagueshme për të kërkuar një punë të re.

Për sa më sipër, në mënyrë të detajuar, procedura e ndjekur për zgjidhjen e marrëdhënies së punës me ankuesen është iniciuar nëpërmjet shkresës nr. 1592, datë 03.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH-së, në të cilën ankuesja është njoftuar për takim pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe ku është diskutuar në lidhje me vazhdimësinë e marrëdhënies të punës. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 1592/2, datë 16.04.2018, ankuesja është njoftuar për ndërprerje të marrëdhënies të punës. Me Urdhërin nr. 274, datë 16.04.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm, D.H i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Referuar Urdhërit të sipërpërmendur, është përcaktuar se në zbatim të nenit 143, pika 1 të Kodit të Punës, D.H i ndërpriten marrëdhëniet e punës, pas një periudhe 3 muajore, përkatësisht në datën 16.07.2018. Gjatë kësaj periudhe, ajo ka përfituar 20 orë leje të pagueshme në javë për të kërkuar punë të re, sipas parashikimit të nenit 143, pika 5, të Kodit të Punës. Njëkohësisht, në zbatim të nenit 145 të Kodit të Punës ajo ka përfituar shpërblim për vjetërsi në masën 3 paga, si dhe në zbatim të neneve 92 dhe 94 të Kodit të Punës, D.H ka përfituar 14 ditë leje vjetore. Në këtë kontekst, Komisioneri nuk konstaton qëndrim të padrejtë të mbajtur ndaj ankueses nga ana e titullarit të FSDKSH-së.

Referuar shkresës nr. 1158, datë 12.03.2018 “Relacion i Komisionit të Ristrukturimit” të përcjellë nga FSDKSH, lidhur me strukturën dhe përshkrimet e punës aktuale dhe të mëparshme të institucionit, rezulton se Drejtoria e Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave ka pësuar ndryshime

---

<sup>4</sup> Kompetencat e Këshillit Administrativ, Neni 5/1/k “Përcakton numrin e përgjithshëm të punonjësve të Fondit”.

si në strukturë ashtu dhe në përshkrimet e punës. Në strukturën e mëparshme Drejtoria e Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave ka qenë e organizuar në 3 Sektorë me 12 punonjës, si më poshtë:

- Sektori i Çmimeve dhe Listës së Barnave, 3 punonjës, A.H Përgjegjëse Sektori dhe I.V dhe E.V Specialistë.
- Sektori i Analizës së Rimbursimit, 4 punonjës, D.R Përgjegjës Sektori dhe E.F, D.H, J.Xh Specialistë.
- Sektori i Kontraktiveve, 4 punonjës, Përgjegjës Sektori, dhe 3 specialistë, A.K dhe A.S.

Ndërsa me strukturën e re është organizuar Drejtoria e Rimbursimit me 2 Sektorë dhe 10 punonjës, si më poshtë:

- Sektori i Listës së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, 4 punonjës, A.K Përgjegjës Sektori, L.Ç, D.R dhe E.A specialistë.
- Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Rimbursimit me 5 punonjës, D.G Përgjegjës Sektori, E.F, Z.M, E.P, J.Xh specialistë.

Përsa më sipër rezulton, se nga procesi i ristrukturimit Sektori i Analizës së Rimbursimit është suprimuar dhe është krijuar Sektori i Monitorimit dhe Analizës së Rimbursimit dhe Sektori i Listës së Barnave dhe pajisjeve Mjekësore, gjë që ka sjellë reduktimin e stafit, riorganizimin e vendeve të punës dhe të përshkrimeve të punës. Nga punonjëset e Sektorit të Analizës së Rimbursimit janë sistemuar në pozicionet e tjera punonjëset D.R, E.F, J.Xh ndërsa D.H nuk është rikonfirmuar në pozicionin e punës.

Referuar dokumentacionit të disponuar, punonjësi L.Ç me Urdhrin nr.35, datë 22.01.2018 të A.H me detyrë zv/Drejtor i Përgjithshëm, ka filluar punë në pozicionin si specialist farmacist në Sektorin e Analizës së Rimbursimit në Drejtorinë së Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave përpara se të miratohej struktura e re me Vendimin nr.14, datë 02.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, dhe më vonë me miratimin e strukturës së re dhe riorganizimit të Fondit ka kaluar në detyrën si specialist në Sektorin e Listës së Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, pra jo në sektorin e analizës së rimbursimit.

Në kuadër të shqyrtimit të kësaj ankese, vlen të theksohet fakti se nga informacioni i dërguar nga palët, rezulton se gjatë periudhës së ristrukturimit të Fondit në Drejtorinë e Çmimeve dhe Rimbursimit të Barnave kanë qenë të punësuar dhe dy punonjëse të tjera në pozicionin si Përgjegjës Sektori dhe Specialist Farmacist, përkatësisht A.H dhe I.V të cilat kanë qenë me leje lindje dhe i është ristrukturuar vendi i punës dhe punonjësja A.H është larguar nga puna ndërsa punonjësja I.V është transferuar në një pozicion tjetër.

Gjithashtu, nga informacioni i vënë në dispozicion nga Fondi rezulton se pranë institucionit, gjatë periudhës së vitit 2017-2018, periudhë kur është kryer procesi i ristrukturimit punonjëset: A.LI, S.D, E.H dhe E.M të cilat gjatë periudhës së ristrukturimit kanë qenë me pushim leje lindje, vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit dhe pas kthimit nga leja e lindjes.

Në këtë aspekt, Komisioneri konstaton se D.H, në kuptim të nenit 7, pika 1, të të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nuk është ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë nga ana e FSDKSH-së, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të.

Për sa më sipër, Komisioneri nuk ka tagër të gjykojë mbi nevojat apo procesin e ritrukturimit të një institucioni si FSDKSH, por mbështetur në atributet që i jep ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mund të kryejë konstatim, nëse ankuesja i është nënshtruar apo është ekspozuar një qëndrimi të padrejtë, disfavorizues apo të pabarabartë, për shkakun e mbrojtur që pretendon, nga ana e titullarit të FSDKSH, në krahasim me punonjës të tjerë që ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, në kuptim të nenit 7, pika 1 të këtij ligji.

Mbështetur në analizimin e fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri gjykon se nuk ndodhemi në kushtet e trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues të ankuses, në krahasim me individë të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme, me të, nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

**Për sa më sipër, në mungesë të trajtimit të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues të ankuses nuk ndodhemi në kushtet e diskriminimit për shkakun e pretenduar nga D.H nga ana e Drejtuesit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.**

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, 7/1, 12, 13 nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetas D.H, nga ana e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, për shkak të shtatzanisë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(shkaku: shtatzania)  
(fusha: punesim)